



Në bazë të nenit 4 të Rregullores për përcaktimin e mënyrës, kushteve dhe procedurës për subvencionimin e zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në Qytetin e Shkupit, nr. 08-854/1 të datës 28.01.2025, dhe në lidhje me Programin për aktivitete në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari zyrtarë i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25, 3/26 dhe 6/26), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e subvencioneve për zejtarët dhe zejet deficitare në zhdukje në qytetin e Shkupit për vitin 2026

1. Lënda e thirrjes publike

1.1. Lëndë e Thirrjes publike është subvencionimi i zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në qytetin e Shkupit, të cilët vazhdimisht shënojnë rënie të aktiviteteve.

1.2. Mjetet financiare të cilat Qyteti i Shkupit do ti subvencionojë janë në shumën prej 20.000.00 denarëve për subvencion individual.

1.3. Mjetet nga nënpika 1.2. sigurohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026 në shumën totale prej 400.000.00 denarëve dhe do të ndahen deri në shfrytëzimin e tyre të plotë.

1.4. Thirrja publike do të zgjasë deri më 30.11.2026 ose deri në shterimin e burimeve financiare të siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, varësisht se cila gjendje paraqitet e para.

2. E drejta e pjesëmarrjes

2.1. Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë:

- Zejtarët, banorë të qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Butel, Çair, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër dhe Shuto Orizare) të cilët i plotësojnë kushtet dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm;

- Zejtarë që nuk kanë shfrytëzuar mjete financiare nga Qyteti i Shkupit në vitin aktual;

- Zejtarë të regjistruar në pajtim me Ligjin për zejtarinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 215/15 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21) dhe ata që posedojnë licencë për veprimtari zejtare dhe kryejnë zanate që janë në zhdukje, të cilat sipas të dhënave të përpunuara po shënojnë rënie të vazhdueshme të aktivitetit, përkatësisht zanatet e mëposhtme: jorganxhi, opingabërës, litarë bërës, gëzofxhi, poçarë, kapele bërës, farkëtar, kallajxhi, kazanxhi, punues butonash, punues qirinjsh, punues i kurorave, punues i sitave, sahatçi, punime artizanale - shportarë, punime artizanale - suvenire, punime artizanale shtëpiake, punime filigrani, bizhuteri dhe produkte të ngjashme, prodhim instrumentesh muzikore dhe shalëbërës.

3. Procedura dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve financiare

3.1. Për të përmbushur kushtet për shfrytëzimin e subvencionit, aplikanti është i detyruar të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë të plotësuar;

- Aktvendim për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve, lejen zejtare;

- Gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj;

- Detyrimet e shlyera ndaj Qytetit të Shkupit (taksa komunale - taksa e kompanisë dhe tatimi i pronës) nëse dyqani është në pronësi të aplikantit. Kontrolli do të kryhet nëpërmjet rrugës zyrtare në Qytetin e Shkupit;

- Deklaratë nga aplikanti se nuk ka shfrytëzuar mjete financiare nga Qyteti i Shkupit për asnjë nga qëllimet e lartpërmendura në vitin aktual.

Dokumentacioni i lartpërmendur i plotësuar në mënyrë të plotë dorëzohet në origjinal ose kopje të vërtetuara nga noteri.

Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe i paplotë nuk do të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

4. Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë aplikuesit

4.1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për subvencion, aplikantët duhet ti plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të mos kenë shfrytëzuar mjete financiare nga Qyteti i Shkupit në vitin aktual;
- Duhet të jenë të regjistruar në pajtim me Ligjin për zejtari ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 215/15 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21) dhe Vendimin për shpalljen e zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në territorin e Qytetit të Shkupit ("Lajmëtari zyrtarë i Qytetit të Shkupit" nr. 19/12);
- Një aplikant mund të shfrytëzojë subvencion vetëm një herë për thirrje publike të publikuar në vitin aktual.

5. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

- 5.1. Për të përcaktuar përmbushjen e kushteve për subvencionimin e zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në Qytetin e Shkupit, Kryetari i Qytetit të Shkupit do të formojë Komisionin për zbatimin e procedurës për subvencionimin e zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në Qytetin e Shkupit. (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).
- 5.2. Aplikimet që do të dorëzohen me vonesë, të parregullta (të palexueshme) ose të pa kompletuara dhe të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parapara me Thirrjen publike, Komisioni do t'i refuzojë me Konkluzion dhe të njëjtit nuk do t'i shqyrtojë, dhe për këtë do ti njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.
- 5.3. Për kërkesat që janë të kompletuara, të dorëzuara në kohë dhe që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni përpilon propozim deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit për ndarjen e mjeteve financiare.
- 5.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare, me të cilin miratohet kërkesa për subvencionimin e zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në Qytetin e Shkupit, me subvencion financiarë në shumën prej 20.000 denarëve.
- 5.5. Kërkesat do të shqyrtohen sipas parimit "Kush vjen i pari, shërbehet i pari", përkatësisht sipas rendit të kërkesave të dorëzuara derisa të shterohen mjetet e disponueshme.
- 5.6. Një aplikant mund të shfrytëzojë një subvencion vetëm një herë për thirrje publike të publikuar në vitin aktual.
- 5.7. Thirrja publike shpallet në faqen e internetit www.skopje.gov.mk

6. Afati dhe mënyra e parashtrimit të kërkesave

- 6.1. Kërkesa për subvencionim të zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në Qytetin e Shkupit me dokumentacion të kompletuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shenjë – Fletë aplikim për thirrjen publike për subvencionim të zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje Qytetin e Shkupit), **deri në datën 30.11.2026**.
- 6.2. Nëse burimet e planifikuara financiare shterohen, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes publike përmes faqes së saj të internetit.
- 6.3. Pagesa e mjeteve të lejuara do të realizohet në mënyrë suksesive, sipas rendit të kërkesave të pranuar, sipas parimit "Kush vjen i pari, shërbehet i pari", në bazë të aktvendimit për miratim nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit. Në rast të refuzimit të kërkesës, aplikanti do të njoftohet me shkrim.
- 6.4. Aplikimet për subvencionimin e zejtarëve dhe zejeve deficitare në zhdukje në qytetin e Shkupit janë të disponueshme në Arkivin e Qytetit të Shkupit, në hapësirat e Qytetit të Shkupit, në Seksionin për përkrahjen e zhvillimit të zejtarisë dhe tregtisë dhe në faqen e internetit www.skopje.gov.mk.
- 6.5. Pyetjet për sqarim mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike në Sektorin për zhvillim ekonomik lokal.
Kontakt tel: (02) 3297-284, www.skopje.gov.mk, adresa e email-it: Rukije.Zekiri@skopje.gov.mk; Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk

QYTETI I SHKUPIT